

VENDIM
Nr.850, datë 17.12.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.83, DATË 26.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TARIFAT TELEFONIKE DHE PËR PAGESAT ELEKTRIKE NGA
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të nenit 12 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit” dhe të nenit 38 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.83, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Çdo përdorues i Albtelecom, sh.a.-së, me aftësi të kufizuar, ku përfshihen:

a) Invalidi paraplegjik dhe tetraplegjik;

b) I verbëri, i paaftë për të lëvizur pa shoqërues, në kushte fizike të invaliditetit të grupit të parë, përfiton 2 000 (dy mijë) impulse telefonike në muaj, me tarifë sa 20 për qind e tarifës në fuqi.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Çdo përdoruesi me aftësi të kufizuar, sipas pikës 1, t’i rimbursohet 80 për qind e tarifës në fuqi për çdo impuls, por jo më shumë se 2 000 (dy mijë) lekë në muaj, shumë e cila përfshin tarifën e mirëmbajtjes mujore, prej 200 (dyqind) lekësh.”.

Rimbursimi i tarifës telefonike të parashikohet, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale. Procedurat e rimbursimit të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano